

Politika e Privatësisë

Përditësimi i fundit: 23 Gusht, 2023

1. Hyrje

Ju falenderojmë që vizituat faqen e internetit të WEBART.AL. Ne jemi të angazhuar të mbrojmë privatësinë tuaj dhe të garantojmë sigurinë e informacionit tuaj personal kur ju vizitoni faqen tonë të internetit ose përdorni shërbimet tona. Kjo Politikë e Privatësisë shpjegon se si mblidhen, përdoren dhe mbrohen të dhënat tuaja personale kur ndërveproni me faqen tonë të internetit, ose kur përdorni shërbimet tona.

2. Të Dhënat që Mblidhen

Ne mund të mbledhim disa informacione personale nga ju kur ju ndërveproni me faqen tonë të internetit ose kur ju përdorni shërbimet tona. Këto informacione mund të përfshijnë:

- Informacioni i Kontaktit: Emri, adresa e emailit, numri i telefonit.
- Informacioni Demografik: Lokacioni, preferencat, interesat.
- Informacioni i Përdorimit: Adresa IP, lloji i shfletuesit, informacioni i pajisjes, faqet e vizituara.

3. Si Përdorim Të Dhënat Tuaja

Ne përdorim të dhënat e mbledhura për qëllime të ndryshme, të tilla si:

- Sigurimi dhe Përmirësimi i Shërbimeve: Për të ofruar shërbimet tona, personalizuar përvojën e përdoruesve dhe përmirësuar ofertat tona.
- Komunikimi: Për t'iu përgjigjur pyetjeve, dërguar përditësime dhe dhënë informacion relevant.
- Analitika: Për të analizuar përdorimin e faqes tonë të internetit, monitoruar trendet dhe mbledhur informacion të natyrës demografike.
- Respektimi i Ligjit: Në përmbushje të rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

4. “Cookies” dhe Teknologjitë e Gjurmimit

Ne mund të përdorim “cookies” dhe teknologji të ngjashme të gjurmimit për të përmirësuar përvojën tuaj si përdorues i faqes tonë të internetit. Ju mund të ndryshoni parametrat e shfletuesit tuaj për të refuzuar “cookies”, por kjo mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të pasur qasje të personalizuar në disa veçori të faqes tonë.

5. Ndarja e informacionit me Palë të Treta

Ne nuk shesim, shkëmbejmë ose ndajmë ndonjëherë të dhënat tuaja personale me palë të treta pa miratimin tuaj, me përjashtim të palëve të treta të besuara të cilat na ofrojnë ne shërbime në drejtim të operimit të faqes tonë të internetit, me të cilat ne kemi marrëveshje konfidencialiteti ku përfshihet detyrimisht mbrojtja e konfidencialitetit të të dhënave tuaja.

6. Siguria e të Dhënave

Ne kemi zbatuar masat e nevojshme të sigurisë për të mbrojtur të dhënat tuaja personale nga hyrjet e paautorizuara, ndryshimet, zbulimi ose shkatërrimi.

7. Zgjedhjet Tuaja

Ju keni të drejtën që të aksesoni të dhënat tuaja personale, ti korrigjoni, përditësoni ose fshini ato. Ju mund të revokoni miratimin tuaj për të marrë disa tipe komunikimesh nga ana jonë.

8. Privatësia e Fëmijëve

Shërbimet tona nuk ofrohen për individë nën moshën 18 vjeç. Ne nuk mbledhim me vetëdije të dhënat personale të të miturve pa miratimin e prindërve.

9. Ndryshimet në këtë Politikë të Privatësisë

Ne mund të përditësojmë këtë Politikë të Privatësisë kohë pas kohe për të pasqyruar ndryshimet në praktikat tona ose në kërkesat ligjore. Politika e përditësuar e Privatësisë do të afishohet në faqen tonë të internetit dhe data e "Përditësimit të fundit" do të vendoset në përputhje me kohën e rishikimit.

10. Na Kontaktoni

Nëse do të keni ndonjë pyetje, shqetësim ose kërkesë në lidhje me këtë Politikë të Privatësisë ose mbi të dhënat tuaja personale, ju lutemi të na shkruani në adresën email info@webart.al.